



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



N J O F T I M

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139, njoftohen të gjithë subjektet në listën bashkëngjitur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik të realizimit të projektit “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Tabakut deri të Ura e Tahir Efendisë”, pas plotësimit të kushteve ligjore të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139, Komuna e Gjakovës ka miratuar vendimin me numër 01-463/02-15123 të datës 31.07.2023, për iniciimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Tabakut deri të Ura e Tahir Efendisë” në Gjakovë.
2. Komuna do të nxjerrë vendim preliminar mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar brenda 30 ditëve kalendarike, pas përmbushjeve të kushteve të përcaktuar në dispozitave Ligjit Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139, lidhur me organizimin e dëgjimit publik.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar nga organi shpronësues brenda 30 ditëve kalendarike, pas shpalljes së vendimit të Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Tabakut deri të Ura e Tahir Efendisë” në Gjakovë.
4. Komuna do të mbajë dëgjim publik lidhur me shpronësimin e përhershëm të realizimit të projektit në fjalë.
5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilin mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronë të cilat gjendet brenda kësaj Komune ose Avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjim publik.
6. Çdo person i lartpërmendur do t’i jepet mundësia e arsyeshme për t’i shprehur mendimet e tij/saj verbalisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139.
7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete provat e arsyeshme (dokumente) të cilat dëshirojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose Avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, pronari ose zotëruesi i interesit.

8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar te të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të Komunës së Gjakovës do të mbahet me datën 01.09.2023, në ora 10:00 në Sallën e madhe të Kuvendi të Komunës së Gjakovës.
9. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilindo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim, menjëherë duhet të dërgohet në organin shpronësues një përshkrim i pretendimeve të tij/saj, në bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.

